



Nr. 13 prot  
Dt. 11/04/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 11, datë 06.04.2023

PËR

**MIRATIMIN E AUTORIZIMIT “PËR PËRDORIM BURIMI  
UJOR” PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE, ME  
VENDNDODHJE: LUMI BUNA, BASHKIA SHKODËR, QARKU  
SHKODËR.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit, “Për përdorim burimi ujor”, për veprimtari ndërtimore në brigje (në rastin kur përdorimi është për sip.e strukturës > 150 m<sup>2</sup> dhe > se 5 m hyrje në trupin ujor nga vija e bregut) , të Bashkisë Shkodër, me vendndodhje: Lumi Buna, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Lumi Buna.

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH).

$X_1=457946$	$Y_1=4657383$	$Z_1=10\text{ m}$
$X_2=457966$	$Y_2=4657376$	$Z_2=10\text{ m}$
$X_3=457948$	$Y_3=4657320$	$Z_3=10\text{ m}$
$X_4=457928$	$Y_4=4657326$	$Z_4=10\text{ m}$

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Ndërtimi i një porti (moli) të ri në qytetin e Shkodrës për turizëm.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

